

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XIX, nr. 5708
E premte, 22 shkurt 2019
çmimi 0.40 €

Ahmeti: Askush në Bruksel nuk e ka përmendur idenë e korigjimit të kufijve

FAQE 7



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com



facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR **ABBRUCH** GMBH
www.awr-abbruch.de

FLET PËR "EPOKËN E RE", QEMAJL MUSTAFA

FAQE 4-5



SYNOJ TA RIKTHEJ QEVERISJEN E PDK-SË NË GJILAN

Ish-kryetari i Komunës së Gjilanit, Qemajl Mustafa, ka bërë me dije se synon të bëhet kryetar i Degës së Partisë Demokratike të Kosovës (PDK) në Gjilan, më pas ta rikthejë qeverisjen e kësaj partie në këtë komunë. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", në të cilën ka treguar arsyet e kandidimit të tij, ai ka thënë se Komuna e Gjilanit duhet t'u kthehet qytetarëve të vet. Qemajl Mustafa ka deklaruar se kësaj gare ka vendosur t'i hyjë pas kërkesave të shumë aktivistëve të PDK-së në Gjilan dhe pas konsultimeve me liderin e kësaj partie, Kadri Veseli. Në këtë intervistë Mustafa ka pohuar se qeverisja në Gjilan nuk është në duar të mira, aq më pak në duar të sovranit. Sipas tij, Lutfi Haziri është duke e qeverisur shumë keq Komunën e Gjilanit

PAPUNËSIA, KORRUPSIONI DHE VARFËRIA, PROBLEMET KRYESORE NË KOSOVË

Papunësia, korrupsioni dhe varfëria vazhdojnë të mbesin problemet kryesore me të cilat përballen qytetarët e Kosovës, është thënë në raportin Puls i Publik të Programit të Kombeve të Bashkuara për Zhvillim (UNDP). Sipas këtij raporti, rreth 70 për qind e qytetarëve besojnë se faktorët jomeritorë (lidhjet familjare, rryshfetet, aleancat partiake, miqtë, pamja e jashtme, gjinia) janë faktorët më të



rëndësishëm për marrjen e vendit të punës në sektorin publik

FAQE 3



Lëvizja Vetëvendosje: Presidenti e ka bllokuar KQZ-në

FAQE 5

AKTUALE



JAPONIA DO TA HAPË AMBASADËN NË PRISHTINË

F. 2

NDËRKOMBËTARËT VLERËSOJNË PUNËN QË ËSHTË BËRË NË MENAXHIMIN E MIGRIMIT

F. 6

BAHTIRI DORËZON TE PRESIDENTI PETICIONIN PËR BASHKIMIN E MITROVICËS

F. 7

EKONOMI

PRESIDENTI NUK E DEKRETON LIGJIN PËR PAGAT, HYN NË FUQI NË MËNYRË TË HESHTUR

F. 8

SHALA KUNDËR KONTRABANDËS, URDHËRON VERIFIKIMIN E SECILIT PRODUKT QË TREGTOHET NË KOSOVË

F. 9

KULTURË

MINISTRI GASHI NËNSHKRUAN RREGULLOREN PËR KËSHILLIN DREJTUES TË MUZEUT

F. 6

SPORT

JOSA, THAQI DHE LUSHTAKU, TË PAPREKSHMIT E SUPERLIGËS

F. 18

KOSOVA DHE SHQIPËRIA MËSOJNË KUNDËRSHTARËT PËR EVROPIAN

F. 18

RENOVA
PUTZ
Magedoni
Xhepcisht-Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegijbiznesi.com
info@kolegijbiznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë, Viasat, p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

DINO
Konjuh Lipjan, Magj. Prishtinë Ferizaj-Kosovë
tel & fax +381 38 566 666

Japonia do ta hapë ambasadën në Prishtinë

Ministria e Jashtme e Japonisë, Toshiko Abe, ka njoftuar se shumë shpejt Japonia do ta hapë edhe ambasadën në Prishtinë, e cila do t'i lidhë edhe më shumë dy shtetet dhe dy popujt. Liderët institucionalë kanë mirëpritur hapjen e ambasadës japoneze në Prishtinë si një hap të madh drejt forcimit të marrëdhënieve ndërmjet dy shteteve



Abe, të cilën e ka falënderuar për ndihmën e Japonisë dhënë shtetit të Kosovës.

Nga ana e saj, ministria Toshiko Abe ka pohuar se Japonia mbetet e përkushtuar për ta ndihmuar Kosovën në çdo sferë të saj dhe se është e hapur që partneriteti mes të dy vendeve të jetë edhe më dinamik në të ardhmen.

Ministria e Jashtme e Japonisë është takuar edhe me ministrin e Jashtëm të Kosovës, Behgjet Pacolli. Ky i fundit është shprehur i lumtur që Japonia do ta hapë ambasadën në Prishtinë.

Në shenjë miqësie mes dy popujve, pranë shtatores së Ismajl Qemalit në kryeqytet është mbjellë një qershi japoneze.

PRISHTINË, 21 SHKURT (ER) - Presidenti Hashim Thaçi, kryeministri Ramush Haradinaj dhe ministri i Punëve të Jashtme, Behgjet Pacolli, kanë pritur në takim të ndara ministrin e Shtetit për Punë të Jashtme të Japonisë, Toshiko Abe. Zyrtarët e shtetit të Kosovës me ministrin e Jashtme të Japonisë kanë biseduar për marrëdhëniet ndërmjet dy shteteve dhe për temat me interes bilateral.

Presidenti Hashim Thaçi ka falënderuar ministrin Toshiko Abe për mbështetjen politike që Japonia i ka dhënë Kosovës në tri dekadat e fundit, sidomos në zhvillimin ekonomik, në arsim, media dhe ambient. "Këto ditë shënojmë 10-vjetorin e lidhjeve të marrëdhënieve bilaterale ndërmjet dy shteteve. Vizita juaj në Kosovë dhe nënshkrimi i marrëveshjeve ndërmjet dy shteteve do ta forcojë edhe më shumë këtë bashkëpunim. Për neve Japonia mbetet një shtet strategjik", ka theksuar presiden-

ti Thaçi.

Përveç temave politike dhe ekonomike, në këtë takim është biseduar edhe për bashkëpunimin kulturor dhe sportiv. Presidenti Thaçi ka theksuar se Kosova me atletët e talentuar mezi pret të marrë pjesë në Lojërat Olimpikë që do të mbahen në Tokio më 2020.

Ndërsa ministria e Shtetit për Punë të Jashtme të Japonisë, Toshiko Abe, ka ofruar mbështetjen e Japonisë për Kosovën në të gjitha fushat. Ajo ka theksuar se shumë shpejt Japonia do ta hapë edhe ambasadën në Prishtinë, e cila do t'i lidhë edhe më shumë dy shtetet dhe dy popujt.

Në fund, presidenti Thaçi ka mirëpritur hapjen e Ambasadës Japoneze në Prishtinë si një hap të madh drejt forcimit të marrëdhënieve ndërmjet dy shteteve tona.

Edhe kryeministri Ramush Haradinaj e ka pritur në takim ministrin e Shtetit për Punë të Jashtme të Japonisë, Toshiko

Kosova përfiton një grant rreth 2 milionë euro nga Qeveria japoneze

Ministri i Punëve të Jashtme, Behgjet Pacolli, ka bërë me dije se, pas takimit dypalësh që është zhvilluar në ambientin e Ministrisë së Punëve të Jashtme me delegacionin nga Japonia, i udhëhequr nga ministria e Shtetit për Punë të Jashtme e Japonisë, Toshiko Abe, kanë

nënshkruar edhe një marrëveshje dypalëshe në mes të dy vendeve, nëpërmjet së cilës Republika e Kosovës do të përfitojë një grant me vlerë rreth dy milionë euro. Pacolli ka thënë se Qeveria japoneze nëpërmjet ofrimit të këtij granti synon promovimin e zhvillimit

ekonomik dhe social të vendit tonë nëpërmjet programeve të ndryshme që ndërliken me këtë fushë. "Falënderues dhe mirënjohës shtetit dhe popullit japonez për mbështetjen e vazhdueshme dhe të palëkundur për shtetin dhe popullin tonë", ka thënë Pacolli.

Opozita proteston dhe dorëzon mandatet



TIRANË, 21 SHKURT - Mijëra qytetarë të Shqipërisë protestuan të enjten kundër Qeverisë duke kërkuar largimin e kryeministrit Edi Rama. Kjo protestë u organizua nga opozita shqiptare, e cila një ditë më parë ka djegur mandatet e deputetëve në Kuvendin e Shqipërisë.

Protestuesit u mblodhën para ndërtesës së Kuvendit, kryetari i të cilit, Gramos Ruçi, të mërkurën ka anuluar seancën plenare të planifikuar të mbahej ditën e protestës, pas dyshimeve për akte të mundshme dhune.

Një ditë më parë Policia e Shtetit përmes një deklarate për media tha se ka të dhëna "për nxitje të dhunës dhe organizime me natyrë kriminale". Policia tha se forcat e rendit dhe sigurisë janë të gatshme "t'i përgjigjen me forcën e ligjit dhe në proporcionalitet të plotë, çdo veprimi të paligjshëm apo akti dhune". Kryetari i Partisë Demokratike në opozitë, Lulzim Basha, e vlerësoi si antikushtetues mbylljen e Kuvendit dhe shtoi se vendit duhet t'i hapet rruga për zgjedhje të reja. "Parlamenti në mënyrë joligjore dhe

jokushtetuese ka mbyllur sot dyert se nuk është më Parlament dhe Qeveria për sot është larguar. Ne përmes bashkimit qytetar do të bëjmë të mundur që këto dy ngjarje të rëndësishme sot - mbyllja e Parlamentit dhe rrethimi me tela e gjemba ushtarakë dhe largimi i Edi Ramës të mos jenë ngjarje e një dite, por të kthehen shumë shpejt në zgjidhjen politike dhe t'u japin rrugë zgjedhjeve të lira e të ndershme dhe t'i hapin rrugë një parlamenti nga populli, për popullin dhe të popullit", tha Basha.

DASH: Opozita të mos i dorëzojë në masë mandatet

TIRANË, 21 SHKURT - Departamenti i Shtetit i bën thirrje opozitës në Shqipëri të mos i dorëzojë në masë mandatet dhe ta dënojë publikisht dhunën e ushtruar gjatë protestave. Një zëdhënës i Departamentit të Shtetit i tha

"Zërit të Amerikës" se zëvendësndihmëssekretari i Shtetit për Evropën, Matthew Palmer, ka zhvilluar të mërkurën në mbrëmje dy biseda të veçanta telefonike me kryetarin e Partisë Demokratike, Lulzim Basha dhe me kryetaren e Lëvizjes

Socialiste për Integrim, Monika Kryemadhi. Sipas zëdhënësit të Departamentit të Shtetit, Palmer u bëri thirrje të dy udhëheqësve të opozitës të qëndrojnë të angazhuar në mënyrë konstruktive në proceset demokratike, duke theksuar rolin jetik që par-

titë e opozitës duhet të luajnë në një shoqëri demokratike. Diplomati i lartë amerikan "i këshilloi" dy kryetarët e partive "kundër dorëheqjeve të koordinuara dhe në masë të deputetëve të opozitës nga parlamenti, pasi kjo do t'i dëmtonte



përpjekjet për reforma dhe do të dëmtonte një institucion të rëndësishëm të demokracisë".

Papunësia, korrupsioni dhe varfëria, problemet kryesore në Kosovë

Papunësia, korrupsioni dhe varfëria vazhdojnë të mbesin problemet kryesore me të cilat përballen qytetarët e Kosovës, është thënë në raportin Pulsit Publik i Programit të Kombeve të Bashkuara për Zhvillim (UNDP). Sipas këtij raporti, rreth 70 për qind e qytetarëve besojnë se faktorët jomeritorë (lidhjet familjare, ryshfetet, aleancat partiake, miqtë, pamja e jashtme, gjinia) janë faktorët më të rëndësishëm për marrjen e vendit të punës në sektorin publik

punën e presidentit të Kosovës, ka një rënie prej 0.7 përqindësh. Megjithatë, niveli i kënaqshmërisë me punën e presidentit të Kosovës prin në raport me nivelin e kënaqshmërisë me punën e institucioneve të tjera", është shprehur menaxheri i këtij projekti, Arben Qirezi.

Liria e shprehjes, sipas këtij raporti, ka shënuar rritje prej 6 përqindësh, kurse rritje ka pasur edhe besueshmëria e qytetarëve për punësim në sektorin publik në bazë të meritokracisë.

Në raportin Pulsit Publik i Programit të Kombeve të Bashkuara për Zhvillim (UNDP) thuhet se 13.5 për qind e qytetarëve janë të kënaqur ose shumë të kënaqur me drejtimin politik të Kosovës, që është një rritje prej 7 përqindësh nga tetori i vitit 2017. Megjithatë, 50 për qind e të anke-

tuarve janë ende të pakënaqur ose shumë të pakënaqur me drejtimin politik të Kosovës.

Rreth 34 për qind kanë raportuar se besojnë se vota e tyre mund ta ndryshojë situatën në Kosovë, kurse 37.5 për qind e të anketuarve mendojnë se institucionet qendrore po punojnë në përputhje me interesat e qytetarëve, krahasuar me 18 për qind në tetor të vitit 2016.

Më tutje, thuhet se 23.3 për qind janë optimistë në lidhje me mundësitë e punësimit, që është vlera më e madhe e regjistruar ndonjëherë në anketat e Pulsit Publik. "71 për qind e kosovarëve ndihen të sigurt kur gjenden në rrugë, që është numri më i lartë që nga viti 2013. Megjithatë, ekzistojnë dallime të mëdha ndërmjet bashkësive etnike, pasi vetëm rreth 10 për qind e serbëve

të Kosovës pretendojnë të ndihen të sigurt në rrugë", është thënë në raportin Pulsit Publik të Programit të Kombeve të Bashkuara për Zhvillim (UNDP).

Rreth 70 për qind e qytetarëve besojnë se faktorët jomeritorë (lidhjet familjare, ryshfetet, aleancat partiake, miqtë, pamja e jashtme, gjinia) janë faktorët më të rëndësishëm në marrjen e vendit të punës në sektorin publik. Ky numër, megjithatë, ka pësuar rënie prej 9 përqindësh që nga maji 2018. Në aspektin e çështjeve mjedisore, shumica e të anketuarve deklaruan se kanë njohuri të kufizuar ose nuk kanë fare për këtë temë. Për më tepër, mbi 70 për qind thanë se kanë pak ose aspak njohuri për të drejtën e tyre për të jetuar në një mjedis të shëndetshëm dhe të pastër.

EPOKA E RE

Shqipe HETEMI

PRISHTINË, 21 SHKURT - Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim (UNDP) ka lansuar të enjten Pulsin Publik XV, projekt ky i financuar nga USAID-i. Sondazhi shqyrton situatën socio-ekonomike në Kosovë duke analizuar perceptimet e çështjeve politike, ekonomike, të sigurisë dhe të zhvillimit. Përveç treguesve të zakonshëm kyçë, kjo përmbledhje shqyrton njohuritë e qytetarëve të Kosovës për mjedisin dhe ndikimin e tij në shëndetin e njeriut.

Anketa, e cila u zhvillua në nëntor të vitit 2018, përfshiu 1 306 kosovarë mbi moshën 18 vjeç.

Ngjashëm me anketat e mëparshme, pjesëmarrësit theksojnë se papunësia (29.4 për qind), korrupsioni (13.4 për qind) dhe varfëria (8.6 për qind) janë çështjet kryesore me të cilat ballafaqohet Kosova.

Rezultatet tregojnë një rritje të qëndrueshme pozitive në shumë fusha kyçë, duke përfshirë besimin në institucionet kryesore dhe ndjenjën e sigurisë në publik. Raporti tregon se kënaqshmëria me institucionet kryesore publike është rritur. Sidomos me gjykatat (37.8 për qind) dhe Prokurorinë (35.3 për qind), të cilat janë ngritur në nivelin e kënaqshmërisë me 6.6 për qind, niveli ky më i

lartë i regjistruar ndonjëherë në anketat e Pulsit Publik. "Është një rritje e ndjeshme e kënaqshmërisë së qytetarëve me punën e gjykatave dhe zyrën e prokurorit të shtetit. Ka pasur rritje të kënaqshmërisë me punën e kryetarit të Kuvendit, Kuvendit dhe Qeverisë. Rënie shumë të lehtë ka pasur kënaqshmëria me



Polici dhe mësuesi që dyshohet se abuzuan me të miturën në Drenas, mbesin në paraburgim

PRISHTINË, 21 SHKURT - Zyrtari policor V. V. dhe mësimpldhënisi Sh. Xh., të cilët dyshohen për keqpërdorim seksual të një vajze (A. G.) nga Drenasi, do të vazhdojnë të qëndrojnë në paraburgim. Gjykata e Apelit i ka konsideruar të pabazuara ankesat e avokatëve mbrojtës kundër caktimit të masës së paraburgimit prej një muaji për të pandehurit.

Përmes një njoftimi për media, gjykata ka njoftuar se "në këtë mënyrë mbetet në fuqi aktvendimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë". "I pandehuri V. V. po dyshohet nga ana e Prokurorisë se ka kryer veprën penale



'keqpërdorim seksual duke përdorur pozitën, autoritetin apo profesionin' dhe veprën penale

'ndërrprerja e palejuar e shtatzënisë'. Ndërsa i pandehuri Sh. Xh. po dyshohet për veprën

penale 'keqpërdorim seksual duke përdorur pozitën, autoritetin apo profesionin' dhe veprën penale 'nxitje e akteve seksuale me premtimin e rrejshëm për martesë', është thënë në njoftimin e gjykatës.

I dyshuari V. V., në cilësinë e hetuesit policor, dyshohet se kishte marrë përsipër ta hetonte rastin e përdhunimit të vajzës, që atë kohë ishte e mitur, nga mësimpldhënisi i saj, Sh. Xh. Ndërkohë, Prokuroria Themelore në Prishtinë ka iniciuar procedurë hetimore, nën dyshimet për kallëzim të rremë ndaj vajzës së njëjtë, në lidhje me deklaratat e saj

për abuzimin seksual nga mësimpldhënisi i saj.

Në një komunikatë të lëshuar nga Prokuroria javë më parë është thënë se gjatë hetimeve të zhvilluara gjatë viteve 2017-2018, mbi dyshimet për keqpërdorim seksual ndaj, atëbotë, të miturës nga Drenasi, thuhet se "e dëmtuara A. G. ka mohuar deklaratën e dhënë fillimisht në Policinë e Kosovës, se ishte keqtrajtuar seksualisht nga profesori i saj Sh. Xh.". Pavarësisht kësaj, në atë njoftim në Prokurori nuk ishte bërë e ditur pse tash është nisur procedura hetimore për intervistën që thuhet se është zhvilluar në vitet 2017-2018.

Flet për "Epokën e re", Qemajl Mustafa

Synoj ta rikthej qeverisj

Ish-kryetari i Komunës së Gjilanit, Qemajl Mustafa, ka bërë me dije se synon të bëhet kryetar i Degës së Partisë Demokratike të Kosovës (PDK) në Gjilan, më pas ta rikthejë qeverisjen e kësaj partie në këtë komunë. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", në të cilën ka treguar arsyet e kandidimit të tij, ai ka thënë se Komuna e Gjilanit duhet t'u kthehet qytetarëve të saj. Qemajl Mustafa ka deklaruar se kësaj gare ka vendosur t'i hyjë pas kërkesave të shumë aktivistëve të PDK-së në Gjilan dhe pas konsultimeve me liderin e kësaj partie, Kadri Veseli. Në këtë intervistë Mustafa ka pohuar se qeverisja në Gjilan nuk është në duar të mira, aq më pak në duar të sovranit. Sipas tij, Lutfi Haziri është duke e qeverisur shumë keq Komunën e Gjilanit

**EPOKA
ERE****Muhamet KOCI**

PRISHTINË, 21 SHKURT - Ish-kryetari i Komunës së Gjilanit, Qemajl Mustafa, ka treguar arsyet se pse sërish ka vendosur ta sfidojë veten për kryetar të Degës së Partisë Demokratike të Kosovës (PDK) në Gjilan. Ai ka thënë se vendimi i tij për t'i hyrë kësaj gare ka ardhur pas shumë kërkesave të aktivistëve të partisë në këtë komunë dhe pas konsultimeve që ka pasur me zyrtarët e lartë të Partisë Demokratike të Kosovës. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", ai ka thënë se qëllimi i rikthimit të tij në krye

të Degës së PDK-së në Gjilan është që në mandatin e ardhshëm në këtë komunë ta rikthejë qeverisjen e PDK-së. "Pas kërkesës së një pjese të aktivistëve të degës dhe të qytetarëve të komunës që të kthehem e të kontribuoj për rindërtimin e degës dhe pas konsultimeve me kryetarin Veseli, si dhe me disa nga anëtarët e kryesisë së PDK-së në qendër, vendosa të jem pjesë e procesit zgjedhor në Degën e PDK-së në Gjilan në kushte plotësisht të barabarta dhe demokratike. Pra, e nisim 'lojën' nga fillimi dhe pres që ajo të jetë fer dhe e hapur", ka thënë Mustafa. Ai ka deklaruar se Komuna e Gjilanit

duhet t'u kthehet qytetarëve të saj. Sipas Mustafës, qeverisja tani në këtë komunë nuk është në duar të duhura. "Qëllimi i parë dhe i vetëm i kandidimit tim është rikthimi i PDK-së në qeverisje para se unë të kem ambicie personale. Gjilani duhet t'u kthehet qytetarëve të vet. Tashti nuk është në duar të mira, e aq më pak në duar të sovranit", është shprehur ai. Në këtë intervistë Qemajl Mustafa ka folur edhe për kritikën që dikur kishte për PDK-në si në nivelin lokal, po ashtu edhe në atë qendror. Ai është shprehur i bindur se kishte të drejtë në këto kritika, duke shtuar se ato nuk do të ndikojnë negativisht

në garën për t'u zgjedhur në krye të degës. "Jo aspak. Kritika e bazuar është e shëndetshme në demokraci. Nëse dikush e ka kuptuar ndryshe, e ka pasur gabim, qysh edhe janë bindur ndonjëri në qendër e shumë më shumë në degë që më kanë keqkuptuar", është shprehur ai. Mustafa e ka kritikuar qeverisjen e Lutfi Hazirit në Komunën e Gjilanit. Ai ka thënë se edhe një jabanxhi do ta qeveristë më mirë këtë komunë. "Edhe me pas qenë komunë e huaj Luta nuk e kishte qeveris më keq. Ose, më saktë, as jabanxhi me pas qenë ai nuk e kish prishë kaq shumë. Komunë e politizuar, komunë me korrupsion, me anarki të

ndërtimet, me realizim të dobët të projekteve, me falsifikime që nga kryetari etj", ka thënë Mustafa.

"Epoka e re": Z. Mustafa, keni paralajmëruar se do të kandidoni për kryetar të Degës së Partisë Demokratike të Kosovës (PDK) në Gjilan. Pse vendosët të riktheheni edhe një herë?

Qemajl Mustafa: Pas kërkesës së një pjese të aktivistëve të degës dhe të qytetarëve të komunës që të kthehem e të kontribuoj për rindërtimin e degës dhe pas konsultimeve me kryetarin Veseli, si dhe me disa nga anëtarët e kryesisë së PDK-së në qendër, vendosa të jem pjesë e

en e PDK-së në Gjilan

"Epoka e re": Më herët e keni kritikuar PDK-në si në nivelin lokal, po ashtu edhe në atë qendror. Mund t'ju dëmtoj kjo në garën për kryetar të degës?

Qemajl Mustafa: Jo aspak. Kritika e bazuar është e shëndetshme në demokraci. Nëse dikush e ka kuptuar ndryshe, e ka pasur gabim qysh edhe janë bindur ndonjëri në

qendër e shumë më shumë në degë që më kanë keqkuptuar.

"Epoka e re": Nëse zgjedheni kryetar i kësaj dege, a besoni se mund ta ktheni qeverisjen e PDK-së në këtë qytet?

Qemajl Mustafa: Qëllimi i parë dhe i vetëm i kandidimit tim është rikthimi i PDK-së në qeverisje para se unë të kem

ambicie personale. Gjilani duhet t'u kthehet qytetarëve të vet. Tashti nuk është në duar të mira e aq më pak në duar të sovranit.

"Epoka e re": Si po qeveriset Gjilani nga kryetari i tanishëm, Lutfi Haziri?

Qemajl Mustafa: Shumë keq. Edhe me pas qenë komunë e

huaj Luta nuk e kishte qeveris më keq. Ose, më saktë, as jabanxhi me pas qenë nuk e kish prishë kaq shumë. Komunë e politizuar, komunë me korrupsion, me anarki të ndërtimet, me realizim të dobët të projekteve, me falsifikime që nga kryetari etj.

Lëvizja Vetëvendosje: Presidenti e ka bllokuar KQZ-në

Përfaqësues të Lëvizjes Vetëvendosje, Albulena Haxhiu dhe Adnan Rustemi, kanë akuzuar presidentin Hashim Thaçi për bllokimin njëvjeçar të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ). Përfaqësuesit e LV-së kanë bërë me dije se ky subjekt politik duhet të ketë dy përfaqësues në KQZ. Sipas tyre, çfarëdo vendimi tjetër do të jetë i papranueshëm dhe do të kundërshtohet me të gjitha mjetet ligjore nga ky subjekt politik

PRISHTINË, 21 SHKURT (ER) - Përfaqësues të Lëvizjes Vetëvendosje kanë mbajtur të enjten konferencë për medie, në të cilën kanë folur për bllokimin njëvjeçar të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), siç kanë pohuar ata, nga ana e presidentit Hashim Thaçi. Në këtë konferencë për media kanë folur deputetja e Lëvizjes Vetëvendosje, Albulena Haxhiu, dhe anëtari i deritanishëm në KQZ nga kjo Lëvizje, Adnan Rustemi. Përfaqësuesit e LV-së kanë bërë me dije se ky

subjekt politik duhet të ketë dy përfaqësues në KQZ sikurse edhe LAA dhe koalicioni PAN. Deputetja Albulena Haxhiu ka dhënë shpjegime rreth këtij rasti: "Një ditë para se të votohej rezoluta për dialogun që tenton ta shuajë vetminë e Hashim Thaçit në ndërmarrjen e tij të rrezikshme për shkëmbimin territorial, nga Zyra e Presidencës iu është dërguar të gjitha grupeve parlamentare kërkesa për dërgimin e emrave në KQZ. Përpyekjet për t'i përdorur institucionet kushtetuese, siç është KQZ-ja

për t'i paguar shërbimet e PSD-së, AAK-së dhe Nismës ndaj Thaçit, janë të papranueshme dhe paralajmërim i thellimit dhe zgjerimit të kapësve e të kapjes së shtetit", ka thënë Haxhiu, duke shtuar se, pavarësisht prej kërkesës së Thaçit për dërgim të një emri, Lëvizja Vetëvendosje ka dorëzuar dy emra për dekretim në Zyrën e Presidencës, bazuar në Kushtetutë dhe ligj, anëtarin e deritanishëm të KQZ-së, Adnan Rustemi si dhe Nazlie Balën. Sipas saj, po bëhet një vit qëkur Komisioni Qendror i Zgjedhjeve është bllokuar nga presidenti dhe një vit e gjysmë prej kur është dashur që përbërja e KQZ-së ta reflektojë rezultatin e zgjedhjeve të fundit.

Ndërkaq aktivisti i Lëvizjes Vetëvendosje, Adnan Rustemi, ka theksuar se rreth 40 asamblistë presin më shumë se një vit për ta marrë detyrën. "Shumë kuvende komunale janë dëmtuar nga moscertifikimi i këtyre asamblistëve, shumë

projekte e aktivitete të KQZ-së janë pamundësuar, shumë iniciativa të mbështetura nga organizata ndërkombëtare që kanë të bëjnë me ngritjen e kapaciteteve vepruese të KQZ-së kanë dështuar, e shumë detyrime të tjera ligjore që janë në kompetencë të KQZ-së janë bllokuar, nga bllokimi që i ka bërë presidenti", ka thënë Rustemi.

Zyrtarët e LV-së kanë bërë me dije se për të dytën herë kanë dorëzuar dy të nominuarit për anëtarë të KQZ-së por, sipas tyre, presidenti në kundërshtim me afatet ligjore nuk i ka dekretuar dhe kështu po e mban peng KQZ-në. Ata kanë kërkuar nga presidenti që në përputhje me obligimet të konfirmojë sa më parë dy anëtarët e tyre të KQZ-së dhe kështu të funksionalizohet KQZ-ja. Përndryshe, sipas tyre, çfarëdo vendimi tjetër do të jetë i papranueshëm dhe do të kundërshtohet me të gjitha mjetet ligjore nga ky subjekt politik.

procesit zgjedhor në Degën e PDK-së në Gjilan në kushte plotësisht të barabarta dhe demokratike. Pra, e nisim 'lojën' që nga fillimi dhe pres që ajo të jetë fer dhe e hapur.

"Epoka e re": A keni folur për këtë çështje me leadershipin e kësaj partie dhe sa besoni se mund ta fitoni këtë garë?

Qemajl Mustafa: Garat janë përherë sfiduese. Ndonjëherë më pak e ndonjëherë më shumë. Unë dhe puna ime jemi mirë të njohur për degën në Gjilan dhe për qytetarët e kësaj komune. Le të jetë përcaktim i lirë e demokratik i tyre nëse më duan për udhëheqës ose jo.



Ndërkombëtarët vlerësojnë punën që është bërë në menaxhimin e migrimit

Është përmbyllur projekti i binjakëzimit të BE-së "Fuqizimi i institucioneve të Kosovës në menaxhimin efektiv të migrimit". Përfaqësuesit e institucioneve të Kosovës kanë falënderuar BE-në dhe shtetet zbatuese për kontributin e dhënë në këtë projekt. Ndërkaq përfaqësuesit e BE-së në Prishtinë dhe ambasadorë të huaj kanë vlerësuar punën që është bërë në menaxhimin e migrimit

EPOKA E RE**Faton DËRMAKU**

PRISHTINË, 21 SHKURT - Ministria e Punëve të Brendshme ka mbajtur të enjten konferencën zyrtare në përmbylljen e projektit të binjakëzimit të Bashkimit Evropian: "Fuqizimi i institucioneve të Kosovës në menaxhimin efektiv të migrimit". Me këtë rast, ministri i

Punëve të Brendshme, Ekrem Mustafa, ka vlerësuar lart kontributin e dhënë nga Bashkimi Evropian dhe shtetet zbatuese të këtij projekti. "Projekti i binjakëzimit i Bashkimit Evropian, sikurse edhe të gjitha projektet e tjera të binjakëzimit, ndër të tjera, ka synim fuqizimin e kapaciteteve institucionale me një impakt afatgjatë", ka pohuar ministri

Mustafa, duke shtuar se Republika e Kosovës është e përkushtuar për zhvillimin e strukturuar dhe nuk ka asnjë kompromis kur bëhet fjalë për orientimin e qartë për implementimin e kërkesave që rrjedhin nga Marrëveshja e Stabilizim Asociimit.

Ministri Mustafa ka theksuar se kur bëhet fjalë për riintegrimin e të kthyerve në Republikën e Kosovës, Ministria e Punëve të Brendshme, respektivisht drejtoria përkatëse, ka zhvilluar sistemin për monitorim, janë hartuar hartat e procesit si dhe është zhvilluar plani i trajtimit. "Duhet përmendur si një shembull të suksesit pilotprojektin e shkëmbimit të informatave ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Mbretërisë

Suedeze në fushën e kthimit dhe riintegrimin të të kthyerve", ka thënë ministri Mustafa.

Ndërsa zëvendëshefi i Zyrës së BE-së/PPBE, Riccardo Serri, ka thënë se projekti i binjakëzimit jo vetëm që demonstroi përkushtimin e BE-së për ta vazhduar partneritetin me Kosovën, në procesin e ndërtimit të kapaciteteve në fushën e menaxhimit të migrimit, po ka për qëllim të përfshihet drejtpërdrejt me qytetarët e Kosovës. "Të arriturat në këtë projekt janë vetëm një hap më tutje në bashkëpunimin në mes të Kosovës dhe BE-së për përmbylljen e obligimeve të dala nga Marrëveshja e Stabilizim-Asociimit", ka thënë Serri.

Ambasadorja e Mbretërisë së Holandës në Kosovë, Gerrie

Willems, ka theksuar se është bërë një punë e madhe në menaxhimin e migrimit, në formë të fle-tushkave të informimit, procedura të operimit standard, duke vlerësuar se është e rëndësishme që këto dokumente dhe akte të tjera ligjore të aprovohen dhe të implementohen plotësisht.

Qëllimi i projektit ka qenë fuqizimi i kapaciteteve të institucioneve relevante të Kosovës për menaxhimin efektiv të migrimit si dhe harmonizimin e politikave dhe legjislacionit në përputhje me standardet e BE-së.

Ky projekt është financuar nga BE-ja dhe është zbatuar nga Holanda me partnerët kryesorë, Suedinë dhe Austrinë, ndërsa partnerë të tjerë kanë qenë Letonia, Polonia dhe Belgjika.



Ministri Gashi nënshkruan Rregulloren për Këshillin Drejtues të Muzeut

EPOKA E RE**Qendresa RAMA**

PRISHTINË, 21 SHKURT - Ministri i Kulturës, Rinisë dhe Sportit, Kujtim Gashi, ka nënshkruar Rregulloren për punën e Këshillit Drejtues të Muzeut Kombëtar të Kosovës (MKK). Rregullorja e nënshkruar nga ministri Gashi do ta përcaktojë mënyrën e funksionimit, detyrat dhe përgjegjësitë, procedurat e punës, thirrjen dhe mbajtjen e mbledhjes, mënyrën e vendimmarrjes dhe votimit si dhe çështjet e tjera përkatëse të rëndësishme për punën e Këshillit Drejtues të MKK-së, ndërsa dispozitat e kësaj rregulloreje do të zbatohen nga Këshilli Drejtues, drejtori i MKK-së, njësitë organizative dhe departamentet përkatëse të MKRS-së.

Ndër të tjera, rregullorja parasheh që së paku një herë në vit llogaridhënia e MKK-së të mbikëqyret nga auditori i pavarur

dhe për këtë KD i MKK-së duhet t'i drejtohet me kërkesë MKRS-së. Vetë KD i MKK-së, sipas rregullore, përcakton politikën e Muzeut, po kështu monitoron dhe vlerëson punën e drejtorit të MKK-së, të shkarkojë dhe të zgjedhë atë. Sipas rregullore, KD-ja përbëhet nga pesë anëtarë me një mandat katërvjeçar, me të drejtë rizgjedhjeje dhe anëtarët duhet të jenë persona të dëshmuar nga fusha përkatëse profesionale. Për punën e tij, KD duhet t'i raportojë së paku një herë në tre muaj ministrit.

Ministri Gashi ka thënë se përpilimi i rregullore që parasheh punën dhe funksionimin e Këshillit Drejtues të MKK-së nga këshilli i ri është cilësuar si një nevojë e domosdoshme për ta përmirësuar funksionalizimin e këshillit si dhe për ta ngritur efikasitetin dhe llogaridhënie në këtë institucion. Ai ka pohuar se deri më tani roli i Këshillit Drejtues të MKK-së nuk ka qenë i



specifikuara detajisht, prandaj kjo rregullore mundëson një transparencë më të mirë për kryerjen e punëve të Këshillit Drejtues të MKK-së. "Zbatimi në përpikëri i kësaj rregulloreje pritet

ta ngrehë efikasitetin, efektivitetin dhe llogaridhënie në të gjitha instancat menaxhuese të MKK-së. Kjo pritet të rezultojë edhe në statisfaksion më të mirë të anëtarëve të Këshillit Drejtues,

menaxhmentit të MKK-së, posaçërisht në aspektin e aktiviteteve të përditshme dhe administrative në MKK", ka theksuar ministri Gashi pas nënshkrimit të rregullore në fjalë.

Bahtiri dorëzon petitionin për bashkimin e Mitrovicës te presidenti

Pas dorëzimit të petitionit te presidenti Hashim Thaçi, kryetari i Komunës së Mitrovicës së Jugut, Agim Bahtiri, para gazetarëve ka kërkuar nga presidenti që të marrë një vendim të shpejtë lidhur me këtë, pasi është i zhgënjyer që ende në Kuvend nuk po diskutohet lidhur me këtë petition

**EPOKA
ERE** **Faton DËRMAKU**

PRISHTINË, 21 SHKURT - Kryetari i Komunës së Mitrovicës së Jugut, Agim Bahtiri, ka dorëzuar të enjten petitionin me 16 594 nënshkrime të qytetarëve për bashkimin e qytetit të Mitrovicës te presidenti i Republikës së Kosovës, Hashim Thaçi. Me këtë rast, ai ka kërkuar nga presidenti Thaçi t'i ndërmarrin procedurat e nevojshme ligjore për realizimin e vullnetit të qytetarëve për bashkimin e Mitrovicës.

Kryetari Bahtiri i ka thënë presidentit Thaçi se petitionin po e dorëzon me shpresën që çështja e Mitrovicës të zgjidhet njëherë e përgjithmonë, pasi ajo padrejtësisht dhe pa dashur qytetarët është ndarë. Ndërsa presidenti i Republikës së Kosovës, Hashim Thaçi, ka ofruar mbështetjen e tij të plotë, duke thënë se Mitrovica do të mbetet për jetë e Kosovës dhe se peticioni do të trajtohet në mënyrë shumë serioze.

Pas dorëzimit të petitionit te presidenti, kryetari i Komunës së Mitrovicës së Jugut, Agim Bahtiri, para gazetarëve ka kërkuar nga presidenti që të marrë një vendim të shpejtë lidhur me këtë, pasi që është i zhgënjyer që ende në Kuvend nuk po diskutohet lidhur me këtë petition. "Qyteti i Mitrovicës është ndarë padrejtësisht, pa dëshirën e qytetarëve të saj dhe po vuajnë qytetarët e saj duke e ditur që janë 15 mijë banorë të shpërngulur nga pjesa e veriut dhe janë refugjatë në qytetin e vet me pamundësi që t'i kthejnë prej institucioneve të cilat i kanë krijuar vetë organet dhe ne kërkojmë që pushtetit lokal, i cili ka qenë për ndarje, t'i kthehet njëherë statusi i mëparshëm i Mitrovicës për arsye se tani pjesën e veriut e udhëheqin strukturat paralele dhe ne kërkojmë nga Kuvendi i Kosovës që sa ma parë ta procedojë në Kuvend", ka thënë kryetari Bahtiri.

Po ashtu, Bahtiri ka thënë se



Mitrovica është e bashkuar, por pret që kjo të bëhet edhe në mënyrë administrative. Ai ka shtuar se i gjithë spektri politik e përkrah nismën e tij për bashkim të Mitrovicës, me përjashtim të kryeministrit Haradinaj, i cili, sipas tij, e konsideron joserioze këtë nismë. Peticioni për bashkimin e qytetit të Mitrovicës ka filluar

në fund të vitit të kaluar dhe brenda shtatë ditësh janë mbledhur gjithsej 16 594 nënshkrime nga pjesëtarët e të gjitha komuniteteve. Ideja e kryetarit të Mitrovicës së Jugut, Agim Bahtiri, që të bashkohet Mitrovica, nuk ka gjetur përkrahje në Ministrinë e Administratës dhe Pushtetit Lokal (MAPL). Përmes një

vendimi kjo ministri ka refuzuar kërkesën e qytetarëve të Komunës së Mitrovicës Jugore për bashkim me atë Veriore. MAPL-ja përmes këtij vendimi ka kërkuar nga Kuvendi i Kosovës ta refuzojë nismën legjislative meqë nuk i përmban kushtet dhe kriteret e përcaktuara me Ligjin për nisma legjislative.

Ahmeti: Askush në Bruksel nuk e ka përmendur idenë e korrigjimit të kufijve

PRISHTINË, 21 SHKURT - Kryetari i Partisë Social Demokrate, Shpend Ahmeti, i cili njëherësh është edhe bashkëkryesues i ekipit negociator të Kosovës në dialogun me Serbinë, ka komentuar të enjten deklaratën e presidentit të Kosovës, Hashim Thaçi, se idenë për korrigjimin e kufirit e ka marrë nga ish-presidenti i Kosovës, Ibrahim Rugova. Ahmeti ka thënë se deri më tash askush zyrtarisht nuk e ka bërë një kërkesë të tillë në Bruksel. "Nëse e paska propozuar Rugova e bën kjo më të mirë apo si është puna? Dje e dëgjova (v. j. ministrin e Jashtëm serb), Daçiq, se ky është propozimi i tij. Më pas e dëgjova (v. j. presidentin serb) Vuçiq që ai e paska përkrahur për një kohë të gjatë. Është e qartë kërkesa sepse askush në Kosovë nuk do ta kërkonte këtë. Kjo është e qartë se është kërkesë e Serbisë, por e them zyrtarisht

se formalisht në takime asnjëherë nuk është përmendur as nga ndërmjetësuesit në Bruksel e as që kemi dëgjuar se e ka kërkuar Serbia", është shprehur Ahmeti.

Sipas kryetarit të Prishtinës, platforma e delegacionit të Kosovës nuk është kundër dialogut me Serbinë. Sipas tij, ajo çfarë është dëgjuar deri më tash nga ana e Serbisë janë vetëm ankesat e jo ndonjë kërkesë e saktë. "Por ne e kemi të qartë se çfarë duam. Ne duam njohje nga Serbia në kufijtë ekzistues që i kemi, pa nivel të tretë të qeverisjes. Pastaj mund të flasim për çështje të drejtave të minoriteteve apo çështje të tjera. Kërkesat tona janë të qarta, duhet të flasim për dëmet e luftës, pensionet dhe të gjitha temat që i kemi ngritur", ka shtuar ai.

Presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi, ka përsëritur disa herë se



ideja për shkëmbim të territoreve ndërmjet Kosovës dhe Serbisë është përmendur edhe nga ish-presidenti i Kosovës,

Ibrahim Rugova në vitin 1994. Dialogu në mes të Kosovës dhe Serbisë ka nisur më 2011, me ndërmjetësimin e Bashkimit

Evropian në Bruksel. Procesi i dialogut pritet të përfundojë me një marrëveshje ligjrisht obliguese për të dyja shtetet.

Presidenti nuk e dekreton Ligjin për pagat, hyn në fuqi në mënyrë të heshtur

Prishtinë, 21 shkurt - Presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi, nuk e ka dekretuar apo kthyer në Kuvendin e Kosovës Ligjin për pagat në afatin ligjor prej tetë ditësh. Në këtë rast, sipas Kushtetutës së Republikës së Kosovës, ligji konsiderohet i shpallur pa nënshkrimin e presidentit.

Mosnënshkrimin e këtij ligji e kanë konfirmuar edhe nga Zyra për Informim e presidentit të Kosovës, sipas së cilës, "Projektligji për pagat nuk është dekretuar nga presidenti por, pas përfundimit të afatit ligjor, ka hyrë në mënyrë të heshtur në fuqi". "Zyra e presidentit ka marrë premtime nga sponsorët e këtij projektligji, se do t'i marrin parasysh të gjitha shqetësimet e paraqitura dhe në të ardhmen e afërt do t'i bëjnë plotësimet dhe ndryshimet e nevojshme", thuhet në një përgjigje dërguar "Radios Evropa e Lirë" nga Zyra për Informim e Presidencës.

Afati ligjor prej tetë ditësh për



dekretim apo kthim në Kuvend të këtij ligji kaloi në mesnatën ndërmjet 20 dhe 21 shkurtit. Pasi ka kaluar afati ligjor për një vendim nga presidenti, Ismet Krasniqi, sekretar i përgjithshëm në Kuvendin e Kosovës, ka thënë për "Radion

Evropa e Lirë" se, në bazë të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, Ligji i pagave konsiderohet i shpallur, pa nënshkrimin e presidentit Thaçi dhe publikohet në Gazetën Zyrtare.

Në bazë të Kushtetutës se

Kosovës, ligji i miratuar nga Kuvendi nënshkruhet nga kryetari i Kuvendit dhe shpallet nga presidenti i Republikës, pasi ta ketë nënshkruar brenda tetë ditësh, pasi ta ketë marrë ligjin. Kurse nëse presidenti i Republikës së Kosovës brenda

tetë ditësh pas marrjes së ligjit nuk merr asnjë vendim për shpalljen ose kthimin e tij, ligji konsiderohet i shpallur, pa nënshkrimin e tij dhe publikohet në Gazetën Zyrtare. Kështu që, ligji hyn në fuqi 15 ditë pas publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës, përveç nëse me ligj nuk përcaktohet ndryshe.

Ligji i pagave është miratuar në Kuvendin e Kosovës më 2 shkurt, kurse në zyrën e presidentit ka arritur më 12 shkurt, por gjatë hartimit u ndryshua disa herë, pasi u shtuan pakënaqësitë sociale, nga punonjës në sektorë të ndryshëm publikë, të cilët kërkonin rritjen e koeficientit, përkatësisht rritjen e pagave. Sipas udhëheqësve të institucioneve të shtetit, në bazë të këtij ligji janë rritur pagat për 70 për qind të punonjësve në sektorin publik. Por, pakënaqësi të punëtorëve ka pasur në sektorë të ndryshëm publikë dhe për ulje të koeficientit, rrjedhimisht ulje të pagave.

Ministri Tahiri: Gjykata Komerciale, jetike për të bërit biznes në Kosovë



PRISHTINË, 21 SHKURT (ER) - Ministri i Drejtësisë, Abelard Tahiri, ka pritur të enjten në takim drejtoreshën e Misionit të USAID-it në Kosovë, Lisa Magno. Ministri Tahiri ka bërë me dije për progresin e arritur deri më tani

në rishikimin funksional të sektorit të sundimit të ligjit, pjesë e së cilës është edhe drejtësia komerciale. Tahiri ka potencuar se pas takimeve të shumta me biznese dhe oda që përfaqësojnë interesin e tyre, është parë si e

domosdoshme krijimi i gjykatës komerciale për ta rritur efikasitetin e trajtimit të lëndëve të biznesit.

"Të bërit biznes është ngushtë i lidhur edhe me qasjen e shpejtë në drejtësi", ka potencuar min-

istri Tahiri, duke shtuar se funksionalizimi i kësaj gjykate do të ndihmojë në krijimin e një ambienti më të mirë për bizneset vendore dhe për investitorët e huaj. Ministri Tahiri ka vlerësuar mbështetjen e deritanishme që

ka dhënë USAID-i, duke shtuar se ky bashkëpunim, sidomos ekspertiza e USAID-it, do të jetë e rëndësishme në krijimin e një gjykate komerciale efikase, që do të ndihmojë në qasjen më të shpejtë të bizneseve në drejtësi.

Shala kundër kontrabandës, urdhëron verifikimin e secilit produkt që tregtohet në Kosovë



Ministri i Tregtisë dhe Industrisë (MTI), Endrit Shala, me qëllim të rënies së kontrabandës në Kosovës, ka urdhëruar Inspektoratin e Tregut të MTI-së që në bashkëpunim me inspektoratet komunale të bëjnë inspektime në tregun e Republikës së Kosovës, për të verifikuar çdo dokumentacion të produkteve të importuara nga Serbia dhe Bosnja e Hercegovina, por edhe nga vendet e tjera

**EPOKA
ERE**

A. MAVRAJ

PRISHTINË, 21 SHKURT - Ministri i Tregtisë dhe Industrisë (MTI), Endrit Shala, ka urdhëruar Inspektoratin e Tregut të MTI-së që në bashkëpunim me inspektoratet komunale të bëjnë inspektime intensive në

tregun e Republikës së Kosovës për ta verifikuar çdo dokumentacion të produkteve të importuara nga Serbia dhe Bosnja e Hercegovina, por edhe nga vendet e tjera dhe krahasimin e këtyre dokumenteve me produktet e ekspozuara në tregun tonë. Qëllimi i këtij aksioni është që

të bëhet verifikimi dhe sekuestrimi i secilit produkt që mund të jetë i kontrabanduar dhe tregtohet në Republikën e Kosovës. "Unë jam i angazhuar çdo ditë, që MTI të jetë zë i bizneseve dhe, po ashtu, ta përmirësojmë klimën e biznesit në vendin tonë. Po ashtu MTI-ja është e

obliguar ta zbatojë ligjin dhe kushtetutën e vendit tonë. Është obligim ligjor dhe kushtetues që të ndalojmë çdo lloj kontrabande, të sekuestrojmë çdo produkt për të cilin nuk dëshmohet prejardhja. Me këto veprime ne po mbrojmë qenien e shtetit tonë, njëkohësisht konsumatorin, rrjedhimisht qytetarin e Kosovës", është shprehur Shala. Sipas ministrit Shala, institucionet e vendit tonë do të kenë informacione të sakta për secilin produkt që tregtohet në vendin tonë. "Prandaj,

Inspektorati i Tregut, së bashku me inspektoratet komunale, janë të obliguara që në bazë të kësaj urdhërese të dërgojnë raporte javore për të gjitha të gjeturat gjatë inspektimeve në tregun e Republikës së Kosovës", ka thënë Shala. Shala u ka bërë thirrje të gjithë operatorëve ekonomikë që operojnë në Republikën e Kosovës, që të furnizohen me produkte të cilat i kanë kaluar të gjitha procedurat doganore, sanitare dhe fito-sanitare, para se të ekspozojnë këto produkte për konsumatorët.

UPZ-ja arrin marrëveshje me Telekomin

Prizren, 21 shkurt (ER) - Universiteti "Ukshin Hoti" në Prizren të enjten ka lidhur marrëveshje mbi shfrytëzimin e kontratës publike kornizë për ofrimin e shërbimeve telekomunikuese e lidhur ndërmjet Ministrisë së Administratës

Publike dhe Telekomit të Kosovës. Marrëveshja përfshinë shërbimet telefonike mobile, internet, internet për GPRS, kabull optik, shërbime të telefonisë fikse, shërbime të TV kabllovik. Marrëveshja është nënshkruar nga Arif Riza

ushtrues detyre i Prorektorit për Buxhet, Financa dhe infrastrukturë dhe nga drejtori i shitjeve në Telekomin e Kosovës, Demir Lima. Marrëveshjen e vlerësuan lart përfaqësuesit e UPZ-së dhe të Telekomit të Kosovës.



Ambasadori Minxhozi pret në takim Bahtirin

PRISHTINË, 21 SHKURT (ER) - Ambasadori i Shqipërisë në Kosovë, Qemajl Minxhozi, ka pritur të enjten në takim kryetarin e Mitrovicës, Agim Bahtiri. Kryetari Bahtiri, pasi e ka falënderuar për mikpritjen dhe interesimin e tij për Mitrovicën, e ka njoftuar ambasadorin Minxhozi me situatën e përgjithshme në Komunën e Mitrovicës dhe për përpjekjet që pushteti lokal po bën për zhvillimin ekonomik të komunës. Sipas tij, përmirësimi i kësaj gjendje, stabiliteti i krijuar, si dhe krijimi i kushteve më të mira për

investime ka ndikuar pozitivisht tek investitorët e huaj që të interesohen për realizimin e projekteve të ndryshme. Në këtë takim është biseduar edhe për mundësinë e bashkëpunimit në mes të Komunës së Mitrovicës dhe Republikës së Shqipërisë. Ndërsa ambasadori Minxhozi e ka përgëzuar kryetarin Bahtiri për punën dhe angazhimin e tij për ta përmirësuar jetesën e qytetarëve duke ofruar bashkëpunimin e tij me qëllim të koordinimit të aktiviteteve komunale me atë të Ambasadës së Shqipërisë.



Limaj pret në takim përfaqësuesit e Fondit Kosovaro-Amerikan të Edukimit

PRISHTINË, 21 SHKURT - Zëvendëskryeministri Fatmir Limaj ka pritur të enjten në një takim përfaqësuesit e Fondit Kosovaro-Amerikan të Edukimit (KAEF) të kryesuar nga themeluesi i këtij programi, Dale Pfeiffer. Në këtë takim u

diskutua për rëndësinë e këtij programi, për fondin e bursave në nivelin master në ShBA si dhe për mundësitë e rritjes së këtij fondi për 10 vjetët e ardhshëm.

Zëvendëskryeministri Limaj ka përgëzuar dhe falënderuar për

punën që ka bërë ndër vite kjo organizatë duke iu ofruar mbështetjes së tij politike. Limaj është interesuar në detaje për programet e studimeve që kjo organizatë i mbështet dhe ka kërkuar që të fokusohen edhe në drejtime të ndryshme inovative.

FSK-ja në muajin qershor mban ushtrim fushor në Rahovec

RAHOVEC, 21 SHKURT (ER) - Kryetari i Komunës së Rahovecit, Smajl Latifi, ka pritur në takim disa ushtarë të FSK-së të udhëhequr nga komandanti i Batalionit të Dytë në Istog, Astrit Haliti. "Në takim biseduam për

idenë e mbajtjes së ushtrimit fushor në Rahovec, i cili pritet të mbahet në qershor. Ushtrisë sonë i ofrova mbështetje të rezervë në këto aktivitete", ka shkruar Latifi në llogarinë e vet në "Facebook".



Lladrovci bën homazhe te varri i Shaban Polluzhës

DRENAS, 21 SHKURT (ER) - Me rastin e përkujtimit të 74-vjetorit të rënies së heroit të Kosovës, Shaban Polluzha, kryetari i Komunës së Drenasit, Ramiz Lladrovci, i shoqëruar nga nënkryetari Gani Sylaj dhe bashkëpunëtorët e tij në prani të pasardhësve të Shaban Polluzhës, ka bërë homazhe te varri i tij në fshatin Polluzhë të Drenasit dhe me këtë rast ka vendosur buqetë lulesh.

Shaban Polluzha ka lindur në Polluzhë të Drenasit më 1871. Mbiemrin Polluzha e ka marrë sipas fshatit të lindjes, ndërsa i përket fisit Kastrati. Ai është rritur edhe edukuar në një familje me traditë kombëtare, e njohur edhe për zgjidhjen e konflikteve ndërfamiljare dhe ndërmjerezore. Ishte edhe kryetar i Këshillit Pajtuës në



Drenicë.

Shaban Polluzha ka rënë heroikisht më 21 shkurt të vitit 1945, pas një lufte të ashpër në kullat e Hasan Sylës në Tërstenik kundër divizion-

eve të shumta ushtarake të Serbisë. Ai mbetet një ndër kolosët e historisë sonë kombëtare bashkë me një pjesë të luftëtarëve të tij dhe me trimin e njohur, Mehmet Gradica.

Në Vushtrri arrestohet një person i dyshuar për veprën penale 'lëndim trupor'

VUSHTRRI, 21 SHKURT (ER) - Në Stacionin Policor në Vushtrri është raportuar dhe është iniciuar një rast me elemente të veprës penale 'lëndim trupor'. Sipas deklaratimit të ankueses/viktimit,



bëhet me dije se ajo ishte sulmuar fizikisht nga i dyshuari mashkull shqiptar dhe, si pasojë e lëndimeve, viktima ka kërkuar tretman mjekësor. Bazuar në deklaratën e ankueses dhe elementeve të

tjera rrethimore, përfshirë provat materiale, janë ndërmarrë veprime të nevojshme policore, të cilat i janë paraqitur prokurorit të rastit. Rasti është iniciuar dhe është hetuar si veprë penale 'lëndim trupor' dhe 'dhunë në familje'. Pas procedurave intervistuese, me urdhër të prokurorit të rastit, të dyshuarit i është caktuar masa e ndalimit policor.

Suhareka, rreth 2 450 biznese aktive



SUHAREKË, 21 SHKURT - Kryetari i Komunës së Suharekës, Bali Muharremaj, ka marrë pjesë në tryezën e organizuar nga Qendra e Biznesit në këtë komunë, në të cilën është diskutuar për zhvillimin e sektorit

privat. Muharremaj ka theksuar se në këtë tryezë është bërë me dije se në Suharekë janë rreth 2 450 biznese aktive. "Gjatë kësaj tryeze u debatua për shumë çështje që kishin të bënin me zhvillimin e sektorit privat. Në takim u tha se janë rreth 2 450 biznese aktive në komunë për të cilat drejtori ekzekutiv i Odës Amerikane në Kosovë, Arian Zeka, tha se problemet me të cilat ju ballafaqoheni në i diskutojmë në Odën Ekonomike Amerikane", ka thënë Muharremaj pas përfundimit të kësaj tryeze.

SHQIPTARËT S'KANË MË 'TOKË PËR QETËSI RAJONALE'



Fadil MALOKU

1. Në Evropë dhe gjithë botën perëndimore janë në rritje e sipër forcat patriotike për mbrojtjen e interesave kombëtare që, në fakt, janë në kundërshti të plotë me "kursin" dhe vlerat e deritanishme neoliberalë!
2. Ne si shqiptarë, meqenëse ende kemi për të bërë për interesat tona sublimë identitare, nuk guxojmë dhe nuk

duhet të biem pre e interesave dhe ikonografisë turbokozmopolite të neoliberalizmit, dhe të bëjmë koncesione të reja të stilit "tokë për qetësi rajonale"!

3. Ne duhet ta shfrytëzojmë këtë "klimë" të ndryshimeve ende evolutive, në favor të faktorizimit të interesave tona gjithëshqiptare në Ballkan. Dhe të punojmë për ndërtimin e kapaciteteve: ekonomike, politike, gjeostrategjike e kulturore. Sepse, vetëm kështu ne arrijmë tri objektiva nacionale: atë të krijimit të "peshës së re specifike" në rajon, atë të idesë të mbrojtjes të interesave tona dhe atë të faktorizimit. Ndryshe, sërish do të mbesim në bisht të historisë.

Gjykata Speciale fton për intervistim deputetin Blerim Kuçi

PRISHTINË, 21 SHKURT - Listës së të ftuarve për intervistim nga Gjykata Speciale për Krime të Luftës në Kosovë i është shtuar edhe deputeti i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), Blerim Kuçi. Ai do të paraqitet para Zyrës së Prokurorit, më 12 mars, në Hagë. Kuçi ka bërë me dije lajmin për ftesë nga Gjykata përmes një komunikate për media ditën e enjte. "Sot (e enjte) kam marrë një fletëthirrje dhe një urdhëresë për t'u paraqitur para prokurorit të lartë të Zyrës së Prokurorit të Specializuar në Hagë, më 12 mars 2019. Natyrisht se unë do ta përmbush obligimin tim dhe do t'i përgjigjem kësaj urdhërese", ka shkruar Kuçi.

Kuçi nuk ka treguar se në çfarë cilësie është ftuar, por ka shtuar se kjo përpjekje, për t'i sfiduar ish-pjesëtarët e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, do të dështojë. "Është e sata herë që në këtë mënyrë sfidohen ish-pjesëtarët e UÇK-së dhe bëhen përpjekje maksimale që të barazohet lufta jonë për liri me krimet më makabre që Serbia ka bërë në Kosovë. Unë jam i bindur se edhe kjo përpjekje, si të gjitha të tjerat deri me tash, do të dështojë. Për momentin krejt çfarë di e kam për të deklaruar për opinionin publik, është kaq sa thash më sipër", ka shkruar Kuçi. Formimi i Gjykatës Speciale ka



pasuar një raport të Këshillit të Evropës në vitin 2011, i cili ka konstatuar se ka prova të mjaftueshme për të nisur hetime kundër disa ish-pjesëtarëve të UÇK-së, që dyshohet se kanë

kryer krime kundër serbëve dhe disa shqiptarëve, gjatë dhe pas luftës në Kosovë. Gjykata Speciale do t'i trajtojë krimet e supozuara që përfshijnë periudhën janar 1998- dhjetor 2000.

Ministri Bytyqi dhe ambasadori Kosnett lansuan programin 'Junior Geeks'



PRISHTINË, 21 SHKURT (ER) - Ministri i Arsimit, i Shkencës dhe i Teknologjisë, Shyqiri Bytyqi, së bashku me ambasadorin e ShBA-së në Kosovë, Philip Kosnett, kanë marrë pjesë të enjten në ceremoninë e lansimit të programit "Junior Geeks", e cila është një platformë gjithëpërfshirëse për nxënës të shkollave të mesme për të diskutuar, hulumtuar dhe mësuar teknologjinë, ndërmar-

rësinë, shkencën dhe inovacionin. Me këtë rast, ministri Bytyqi ka përgëzuar bursistët nga Kosova, të cilët kanë arritur që me angazhimin dhe kreativitetin e tyre, në konkurrencë të madhe nga mbarë bota, të përfitojnë mbështetje financiare për zhvillimin e këtij programi në shkollat e Kosovës. "Ne e kemi pasurinë më të madhe rininë dhe kësaj rinie të mrekullueshme i duhet që

t'ia krijojmë mundësitë dhe kushtet sepse talentin e ka, që e tregon edhe ky rezultat i arritur", ka thënë ministri Bytyqi dhe për këtë ka falënderuar ShBA-në dhe të gjithë partnerët që kanë qenë dhe vazhdojnë ta mbështesin arsimin, por edhe çdo sektor tjetër të rëndësishëm në funksion të zhvillimit tonë si shtet dhe si shoqëri. Ministri Bytyqi ka përmendur

shumë angazhime të MASHT-it që lidhen me fushat në të cilat është i fokusuar ky projekt, ndërsa ka theksuar se Ministria e Arsimit do të jetë gjithmonë e gatshme ta mbështesë zhvillimin e programeve nga të cilat përfitojnë të rinjtë tanë. Ministri Bytyqi u shpreh tejet i lumtur që programi "Junior Geeks" është një nga 70 projektet fituese nga mbarë bota (i vetmi nga Evropa Juglindore), i

cili ka fituar mbështetje financiare nga Fondi i Bursistëve për Inovacion i Departamentit Amerikan të Shtetit nëpërmjet Ambasadës Amerikane në Prishtinë dhe Qendrës Inovative të Kosovës. Programi do të zhvillohet në shkollat e mesme të tri komunave të Kosovës (Prishtinë, Pejë dhe Mitrovicë), me mundësi të zgjerimit edhe në shkollat e komunave të tjera.



—Arijeta Pajaziti Qerimi
Specialized Engineer for
SCADA/EMS; Executive Director
of AWESK

WE

Women in Energy

are bringing innovation and technology in Kosovo's economy. Women in Energy Scholarship Program by MFK will support the incredibly innovative women to bring a new spark in our energy sector.

Arijeta Pajaziti Qerimi is one of the first women energy software developers in Kosovo. She is also one of the founders and the Executive Director of the Association of Women in the Energy Sector of Kosovo (AWESK) with over 130 women members working in the energy sector. She is an electro—engineer and works as a specialized SCADA/EMS engineer at KOSTT.

Learn about our scholarships and find out how to apply using the link below.

millenniumkosovo.org/womeninenergy

Find us at:
Millennium Foundation
Kosovo

9th floor of the former
Ljubljana Bank Building
Migjeni Str. 21,
10000 Prishtina,
Republic of Kosovo



E rrallë

Breshka gjigante

Një specie breshke gjigante që besohej të ishte zhdukur më shumë se 100 vjet më parë është zbuluar në ishujt Galapagos. Shumë lloje të breshkave të mëdha u kapën nga kolonizatorët evropianë për mishin e tyre. Zbulimi i fundit erdhi pas një ekspedite në ishullin "Fernandina", në rajonin ekuadorian perëndimor të arkipelagut. "Fernandina Giant Tortoise" është një nga 14 speciet gjigante breshkash në Galapagos, por vetëm dhjetë mendohet se i kanë mbijetuar kolonizimit njerëzor dhe mbigjuesisë për ushqim.



tuar kolonizimit njerëzor dhe mbigjuesisë për ushqim.

FOTO E DITES



Kamboxhianët lëshojnë fenerë gjatë festimit budist të 'Meak Bochea' në Penh. /AFP/

E jashtëzakonshme

Trupi i gruas gjendet në frigorifer 18 vjet pasi u zhduk

Trupi i një gruaje të zhdukur 18 vjet më parë është gjetur brenda një frigoriferi në një fshat kroat. Policia ka njoftuar se trupi i saj u gjet në fshatin Pavlovec, në verilindje të Zagrebit. Trupi i gruas u zbulua i mbështjellë në letër alumini, pas ndërprerjes së energjisë



elektrikë në banesë, gjë që shkaktoi që kufoma të fillonte të merrte erë.

BARSOLETA E DITËS



- A të ndihmojë ilaçi që ta dhashë herën e fundit?
- Shumë.
- Gabimisht xhaxhai e piu atë dhe unë mbeta i vetmi trashëgimtar i pasurisë së tij.



Programi i shfaqjes së filmave në Kino ABC

Në ora 16:00

"THE GRINCH" 3D,

I Animuar/Komedi/Familjar; 1 ore 30 min

Rolet: Benedict Cumberbatch, Rashida Jones, Kenan Thompson, Cameron Seely, Angela Lansbury, etj.

Regjia: Scott Mosier, Yarrow Cheney



Në ora 17:30

"THE NUTCRACKER AND THE FOUR REALMS" 3D

Aventure/Fantazi/Familjar; 1 ore 39 min

Rolet: Keira Knightley, Mackenzie Foy, Eugenio Derbez, Mathew Macfayden, Helen Mirren, Morgan Freeman, etj.

Regjia: Lasse Hallstrom, Joe Johnston

Në ora 19:30

"MORTAL ENGINES" 3D,

Komedi; 1 ore 51 min

Rolet: Hugo Weaving, Hera Hilmar, Robert Sheehan, Jihae, Ronan Rafferty, Leila George, Patrick Malahide, Stephen Lang, etj.

Regjia: Christian Rivers



Në ora 22:00

"HUNTER KILLER",

Aksion/Aventure/Fantazi; 2 ore 08 min

Rolet: Gerard Butler, Gary Oldman, Common, Linda Cardellini, Toby Stephens, Michael Nyqvist, Caroline Goodall, etj.

Regjia: Donovan Marsh

Për informata dhe rezervime të biletave thirrni **FALAS: 0800 22 222** dhe **boxoffice@kinoabc.info, www.kinoabc.info, fb: Kino ABC.**



DASHI

Një ditë e dedikuar vetëm për çështjet e biznesit. Jeni të fiksuar tek hollësitë e një marrëveshjeje që do të thotë shumë për ju.


Jeni të fiksuar tek hollësitë e një marrëveshjeje që do të thotë shumë për ju.



DEMI

Po korni frytet e asaj çfarë keni mbjellë në të shkuarën. Keni qenë mjaft skrupuloz në gjërat që keni vendosur të bëni dhe kjo ju ka zgjidhur punë.

Po korni frytet e asaj çfarë keni mbjellë në të shkuarën. Keni qenë mjaft skrupuloz në gjërat që keni vendosur të bëni dhe kjo ju ka zgjidhur punë.



BINJAKËT

Racionalë dhe mjaft të ftohtë në mendime, sot do të jeni udhërrëfyes për shumë nga miqtë tuaj, të cilët do t'ju kërkojnë këshilla.

Racionalë dhe mjaft të ftohtë në mendime, sot do të jeni udhërrëfyes për shumë nga miqtë tuaj, të cilët do t'ju kërkojnë këshilla.



GAFORRJA

Keni rënë pre e rutinës kohët e fundit dhe kjo gjë po ju dëmton sepse nuk doni të dilni ose nuk po gjeni motivin për të dalë prej saj.

Keni rënë pre e rutinës kohët e fundit dhe kjo gjë po ju dëmton sepse nuk doni të dilni ose nuk po gjeni motivin për të dalë prej saj.



LUANI

Po merreni me një investim tuajin tek i cili besoni pavarësisht prej skepticizmit të partnerit. Jeni gjithë kohën të zënë me këtë prioritet.

Po merreni me një investim tuajin tek i cili besoni pavarësisht prej skepticizmit të partnerit. Jeni gjithë kohën të zënë me këtë prioritet.



VIRGJËRESHA

Sot ndiheni të qetë dhe të plotësuar në lidhjen në çift. Do të bëni një udhëtim që do t'ju kujtojë kohët e shkuara.

Sot ndiheni të qetë dhe të plotësuar në lidhjen në çift. Do të bëni një udhëtim që do t'ju kujtojë kohët e shkuara.



PESHORJA

Sot do të bini pre e nostalgjisë dhe gjithë dita do t'ju shkojë mes kujtimeve. Nuk po shihni diçka konkrete për të ardhmen tuaj.

Sot do të bini pre e nostalgjisë dhe gjithë dita do t'ju shkojë mes kujtimeve. Nuk po shihni diçka konkrete për të ardhmen tuaj.



AKREPI

Po vini në praktikë gjithçka që keni krijuar lidhur me një ngjarje të caktuar sot. Jeni mjaft i përkushtuar që gjërat të dalin mirë.

Po vini në praktikë gjithçka që keni krijuar lidhur me një ngjarje të caktuar sot. Jeni mjaft i përkushtuar që gjërat të dalin mirë.



SHIGJETARI

Sot jeni në mëdyshje të besoni logjikën apo intuitën tuaj. Keni prova që intuita s'ju ka lënë në baltë, por dhe duhet të logjikoni mbi vendimet që merrni.

Sot jeni në mëdyshje të besoni logjikën apo intuitën tuaj. Keni prova që intuita s'ju ka lënë në baltë, por dhe duhet të logjikoni mbi vendimet që merrni.



BRICJAPI

Besojini perceptimit tuaj sepse do t'ju udhëheqë pikërisht aty ku doni të arrini. Dita do të mbyllet me një lajm të gëzueshëm.

Besojini perceptimit tuaj sepse do t'ju udhëheqë pikërisht aty ku doni të arrini. Dita do të mbyllet me një lajm të gëzueshëm.



UJORI

Nuk ndiheni mirë nga ana emocionale në këtë periudhë. Ndieni mungesën e dikujt dhe do ta kompensoni duke harxhuar për blerje.

Nuk ndiheni mirë nga ana emocionale në këtë periudhë. Ndieni mungesën e dikujt dhe do ta kompensoni duke harxhuar për blerje.



PESHQIT

Sot duket që nuk jeni ngritur me humor të mirë sepse do të kapeni me këdo që ju qëndron pranë. Priten debate gjatë gjithë ditës.

Sot duket që nuk jeni ngritur me humor të mirë sepse do të kapeni me këdo që ju qëndron pranë. Priten debate gjatë gjithë ditës.


Meghan Markle në Nju Jork, shëtitje dhe darka luksoze me mikeshat



Meghan Markle ka zbritur në Nju Jork, për herë të parë pas martesës së saj në maj të 2018-s me princin Harry. Ajo ndodhet në Amerikë për festën e Baby-showerit, me mikeshat e saj më të dashura, por Dukësia e Sussex ka përfituar nga rasti për t'u relaksuar, duke vizituar muzetë dhe

duke darkuar në restorante luksoze, si ajo me Serena Williamsin. E shoqëruar nga zyrtarë të Departamentit të Shtetit dhe nga stafi i sigurisë mbretërore, ajo zbavitet në Nju Jorkun e ftohtë dhe tregon barkun e saj, në muajin e shtatë të shtatzënisë. Royal Baby pritet të vijë në jetë në pranverë.

Paris Hiltoni darkon me miq, jashtë lokalit konsumoi cigare



Biznesmenja Paris Hilton është fotografuar nga paparacët së fundi. Ajo është parë në rrugët e

Hollywoodit duke u shoqëruar nga disa miq. Hiltoni shihet se është duke konsumuar cigaren jashtë lokalit ku darkuan.



Dua Lipa çmend serbët, në "Brit Awards" me fustan me ngjyrat e flamurit të Kosovës

Këngëtarja shqiptare Dua Lipa po korr suksese të njëpasnjëshme. Të mërkurën Dua është shpërblyer me çmim në "Brit Awards 2019", bashkë me Calvin Harrisin. Kënga "One Kiss", e Dua Lipës, në duet me Calvin Harrisin, u zgjodh "Kënga më e mirë e vitit".

Dua u ngjiti në skenë për ta kënduar 'live' këtë këngë, pak para se ta merrte çmimin, i cili vjen pas dy çmimeve 'Grammy' që ajo mori javën e kaluar. Por, ajo që ka rënë në sy ishte fakti se këngëtarja shqiptare është veshur me ngjyrat e flamurit të Kosovës, verdhë e blu.

Cardi B i blen dhuratë vajzës në vlerë të 5 900 dollarëve



Reperja amerikane Cardi B i ka blerë dhuratë vajzës. Kulture mori një byzylykë dore nga nëna. Ky byzylyk është

me diamante dhe kap vlerën e 5 900 dollarëve amerikanë. Ai përmban emrin e plotë të vajzës.



EURO GLASS
SAINT-GOBAIN SEKURIT PILKINGTON
Enveri
Adr: Fushë Kosovë
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336
E-mail: euro.glass@live.com



QENDRA SPORTIVE
"BUJQËSIA"
TEL: 045/82 82 82

PROGNOZA SPORTIVE	WEST HAM - FULHAM	1	MILAN - EMPOLI	1-1	STRASBOURG - LILLE	2
-------------------	-------------------	---	----------------	-----	--------------------	---

Josa, Thaqi dhe Lushtaku, të paprekshmit e Superligës



Prishtina, Flamurtari dhe Drenica janë skuadrat e vetme që ende nuk kanë bërë ndryshime në shtabet teknike, por gjithçka mund të ndodhë deri në përfundim të këtij kampionati. Analisti i futbollit, Genc Sermaxhaj, ka vlerësuar se ndryshimet në klube kanë efekt të dyanshëm por, sipas tij, trajnerët kur dalin jashtë objektivit të klubit është e rrugës që të japin dorëheqje

mund të dimë se çka mendojnë kryesit e klubeve, por mund të bëjmë vlerësime nga këndvështrimet tona për mënyrën se si ekipet e tyre luajnë dhe çfarë mund të sjellin ndryshimet në ato ekipe. Nëse ndonjë nga trajnerët nuk është në objektivat e klubit, sigurisht se duhet dhënë dorëheqje, por duhet të kemi kujdes se rezultatet pozitive nuk varen vetëm nga trajneri", ka thënë Sermaxhaj.

firmuar muaj më parë se Josa do të mbetet trajner i skuadrës deri në fund të kampionatit, por eliminimi nga Kupa dhe humbja e pozitës së parë në kampionat mund të ndikojë edhe në largimin e tij. Sermaxhaj ka shprehur mendimin se Mirel Josa me Prishtinën është brenda objektivit të klubit dhe se tash për tash nuk mund të parashikohet e ardhmja e tij. "Askush nuk mund të thotë se Prishtina e ka humbur titullin, ose Josa nuk është në objektivin e tij dhe të klubit. Ka shumë lojë deri në fund dhe nuk është e drejtë të themi se a do të dalë apo jo kampion", ka shtuar Sermaxhaj.

EPOKA E RE Veton ZYMBERI

PRISHTINË, 21 SHKURT - Nuk ishte pritur që trajneri Sadat Pajaziti të largohet nga Gjilani për faktin se synimi i tij ishte të krijohet një skuadër solide, në mënyrë që edicionin e ardhshëm të luftojë për trofe, por të mërkurën klubi nga Anamorava bëri publik lajmin e ndërprerjes së bashkëpunimit

me trajnerin nga Tërnoci. Në fakt, klubi i Gjilanit është i nënti që bën ndryshime në shtabin teknik dhe aktualisht vetëm Mirel Josa i Prishtinës, Arsim Thaqi i Flamurtarit dhe Tahir Lushtaku i Drenicës janë ata që po i bëjnë ballë ndarjes me klubet që filluan kampionatin 2018/2019. Analisti i futbollit, Genc Sermaxhaj, ka thënë të enjten për "Epokën e re" se

ndryshimet nëpër klube i kanë anët pozitive dhe negative. Ish-lojtari i disa klubeve në Kosovë ka pohuar se nëse një trajner është jashtë objektivave të klubit, atëherë dorëheqja është veprimi më i duhur nga ana e tij. "Ndryshimet në futboll nganjëherë janë të mira sepse sjellin freski te futbollistët, por nganjëherë edhe nuk janë të qëlluara varësisht prej objektivave të klubeve. Ne nuk

SHKURT

Federata Botërore e Mundjes ndihmon mundjen e Kosovës

Federata Botërore e Mundjes (UWW) i ka dhuruar një tapet të mundjes Federatës së Mundjes të Kosovës. Ky donacion vjen falë raporteve të mira që ka ndërtuar Federata e Mundjes e Kosovës me United World Wrestling. Tapeti i mundjes është i standardeve botërore dhe do t'i shërbej FMK-së për organizimin e ngjarjeve vendore dhe ndërkombëtare.

Federata Skitare rikthehet në zyrën e saj

Federata Skitare e Kosovës është rikthyer në zyrën e saj në Qendrën e Skijimit në Brezovicë pas intervenimit të Ministrisë për Kulturë, Rini dhe Sport, si dhe organeve të rendit të Republikës së Kosovës. "FSK-ja vazhdon punën edhe nga kjo zyrë në Brezovicë, ku më 2 dhe 3 mars planifikohet të organizohet Kampionati i Kosovës në dy disiplina: sllalom dhe sllalom i madh për kategoritë e vjetra", thuhet në njoftimin e Federatës Skitare të Kosovës.

Thumm, kundërshtarja e parë e Majlindës në Dusseldorf

Kampionia olimpike Majlinda Kelmendi do të garojë nesër në Grand Slam-in e Dusseldorfit. Majlinda rrethin e parë e kalon pa luftë, kurse në rrethin e dytë do të përballet me gjermanen Verena Thumm në kategorinë deri 52 kilogramë. Majlinda Kelmendi është garuesja e vetme nga Kosova që merr pjesë në këtë garë, kurse synimi i saj është ta fitojë medaljen e artë.

Grezda rikthehet në stërvitje

Futbollisti i kombëtares shqiptare, Eros Grezda, është kthyer në stërvitje për Rangersin në Skoci, duke lënë pas çdo dëmtim që e ka shqetësuar në dy muajt e fundit. Lajmi për rikthimin e Grezdes u bë i ditur nga një postim i futbollistit nga Kosova në "Instagram". Grezda në pjesën e parë të sezonit në 10 ndeshje shënoi dy gola me fanellën e Rangersit.

Kosova dhe Shqipëria mësojnë kundërshtarët për Evropian

PRISHTINË, 21 SHKURT - Përfaqësuesja e Kosovës në konkurrencën e femrave në futboll i ka mësuar emrat e kundërshtarëve të kualifikimeve për Kampionatin

Evropian 2021. Kosova bën pjesë në Grupin A, i cili është mjaft i fuqishëm, kurse kundërshtarë do ta ketë Holandën, Rusinë, Slloveninë, Turqinë dhe Estoninë. Ndërsa

Kombëtarja e Shqipërisë bën pjesë në Grupin E së bashku me Skocinë, Finlandën, Portugalinë dhe Qipron. Kualifikimet për kompeticionin që do të mbahet në

Angli do të fillojnë më 26 gusht, ndërsa do të përfundojnë më 27 tetor 2020. Kurse ky eveniment prestigjioz do të mbahet në korrik të vitit 2021 në Angli.



Simeone kërkon falje: Gjesti im nuk kishte objektiv Juventusin

MADRID, 21 SHKURT - Trajneri Diego Simeone festoi si një ultras, me një gjest të shëmtuar, golin e parë ndaj Juventusit. I intervistuar nga "Sky", trajneri argjentinas shpjegoi gëzimin e tij pas golit të Gimenezit, kur u drejtua nga tribuna e "Wanda Metropolitano" dhe bëri me

duar nga organet gjenitale, duke dashur t'ia nxjerrë në pah dikujt ato. "Thjesht, tregova çfarë ndjeva në atë moment. Në qoftë se dikush është ofenduar, kërkoj falje. Nuk ishte një gjest drejtuar tifozëve të Juves. Ndeshja më e mirë e Atletico Madridit? Edhe me Borussia Dortmundin kemi

luajtur shkëlqyeshëm. Kemi rikuperuar lojtarë të rëndësishëm si Koke e Diego Costa. Edhe Saul është përmirësuar shumë. Ne kemi qenë në gjendje të luajmë një ndeshje inteligjente. U përballëm me një ekip të madh, me lojtarë të fortë dhe u përpoqëm të përfitojmë nga çdo situatë. Në

fund morëm një rezultat të mirë", ka thënë Simeone. "Ne e dimë, megjithatë, vështirësinë e të luajturit në Torino. Juventusit është një ekip i madh, një klub i madh. Në përbërje ka kampionë të mëdhenj. Ne do të duhet të vuajmë në ndeshjen e kthimit", ka deklaruar Simeone.



Futbollisti nga Hondurasi: Në Kosovë e duan futbollin, Prizreni qytet i bukur

PRIZREN, 21 SHKURT - Roby Norales ishte një nga përforcimet e Lirisë së Prizrenit gjatë afatit të shkuar. Sulmuesi 28-vjeçar ka luajtur edhe një takim me Kombëtaren e Hondurasit, por pa mundur të vazhdojë më tej me atë fanellë. Karriera e tij është e pasur dhe në kontinente të ndryshme, ndërsa rrugëtimin e vazhdoi në Kosovë. Sipas një interviste të publikuar së fundmi nga ana e këtij lojtari, Norales ka rrëfyer gjithë përshypjet e tij të para, shkruan "Shqipëria.ch". Ashtu siç edhe vetë futbollisti i Hondurasit do të shprehej, komentet e marra nga shokët e tij dhe pritshmëria për Kosovën nuk ishte edhe aq e mirë, gjë e cila ndryshoi menjëherë pas zbritjes në trevën shqiptare. "I ftohti që kur kam arritur ka qenë shumë i shëmtuar, tre gradë nën zero. Por, jam duke u përshtatur, për t'u futur në fushën e lojës e për të vazhduar në mënyrën e duhur. Kur mbërrita në Kosovë mendoja se njerëzit




do të ishin arrogantë dhe nuk do ta mbështesnin futbollin. Por, në momentin që unë lë apartamentin, kur shkoj për të ngrënë diçka apo në stadium, takoj njerëz që më pyesin për të bërë foto. Ata janë vërtet tifozë të futbollit dhe që e duan këtë sport", ka thënë Norales. "Kur kam pyetur për Kosovën fillimisht nëpër miqtë e mi, shpreheshin se

ishte një vend ende në luftë, pasi kishte shumë masakra me Serbinë. Por vendi është në gjendje të mirë tani dhe qyteti (Prizreni) është i bukur. Ushqimi nuk ka ndryshuar dhe nuk ka pula të pjekura siç i kemi ne të zakonshme në Honduras. Këtu ka më shumë perime, duke na ndihmuar që të jemi edhe më profesional", u shpreh Norales.

10 pronarët më të pasur të klubeve të futbollit

LONDËR, 21 SHKURT - Pas klubeve më të mëdha të futbollit janë njerëz të fuqishëm ekonomikisht, por kurrësi kjo nuk do të thotë se më të pasurit zotërojnë domosdoshmërisht skuadrat më të forta në botë. E përditshmja angleze "Mirror" është përpjekur të bëjë një klasifikim sa më të saktë, duke hartuar listën e 10 pronarëve të klubeve të futbollit në bazë të pasurisë së tyre. Prej këtyre, pesë zotërojnë klube që militojnë në Premier Ligën angleze, dy zotërojnë klube italiane, dy klube amerikane dhe një, klub francez. Në vend të dhjetë të klasifikimit është Joe Lewis, një ndër njerëzit më të pasur të Mbretërisë së Bashkuar, pronar i Tottenham Hotspurit. Me një pasuri prej 3.8 mld sterlinash, Lewis ka financuar së fundmi ndërtimin e stadiumit të ri të "Spurs"-ave, një projekt 800 milionë sterlina, raporton "SS". Në vend të nëntë, Zhan Jindong, themelues i "Suning.com", i cili nëpërmjet "Suning Holdings Group" bleu mazhorancën e aksioneve të Interit. Pasuria e tij, sipas "Mirror"-it, vlerësohet 5.2 miliardë sterlina. Në vend të tetë,



Shahid Khan, i cili zotëron Fulhamin, pasuria e të cilit është 5.4 miliardë sterlina. Nasser Al-Khelaifi, pronar i Paris Saint-Germain, renditet në vend të shtatë, pasuria e të cilit vlerësohet në 6.2 miliardë sterlina. Një vend më sipër, pronari i Arsenalit, Stan Kroenke, pasuria e të cilit është 6.4 miliardë sterlina. Në mes të klasifikimit, Roman Abramovich, i Chelseat (8.3 miliardë), të cilit i paraprin Philip Anschutz, pronar i Los Angeles Galaxy. Pronari i klubit ku luan Zlatan Ibrahimoviç është një ndër njerëzit më të pasur aktiv në botën e sportit, me një pasuri 10 miliardë sterlina.

Në vend të tretë familja Agnelli, e cila zotëron klubin e Juventusit. Me një pasuri prej 10.4 miliardë sterlinash, familja Agnelli është dinastia sportive më jetëgjatë në Itali. Medalje argjendi për Sheikh Mansour, pronar i Manchester City (pasuria e të cilit vlerësohet 17 miliardë sterlina). Në vend të parë të klasifikimit të "Mirror"-it është Dietrich Mateschitz, pronar i New York Red Bullsit, por edhe i Leipzigit dhe Salzburgut, pasuria e të cilit është 17.8 miliardë sterlina. Bashkëthemeluesi i kompanisë së pijeve energjike "Red Bull", Mateschitz, angazhohet në sporte të shumta.

SHKURT

Ronaldo, tifozëve të Atletico: Unë kam pesë Liga të Kampionëve

Cristiano Ronaldo nuk bëri shumë në fushë për ta ndihmuar Juventusin që t'i shmanget humbjes nga Atletico Madridi. Ai gjatë ndeshjes ngacmoi tifozët e Atletico, duke iu kujtuar se në karrierën e tij i ka fituar pesë Liga të Kampionëve. "Unë kam pesë Liga të Kampionëve, ata asnjë. Do ta shohim kush do të kualifikohet", ka deklaruar Ronaldo pas ndeshjes.

"Bild": Kështu po jeton legjenda Michael Schumacher

"Kjo është mënyra se si ish-kampioni i Formulës 1, Michael Schumacher, jeton sot", ishte titulli i gazetës gjermane "Bild", që rindez shpresat e lexuesve të saj për një përmirësim të mundshëm të kampionit të Formulës 1. "Për kujdesin ndaj Schumit ka rreth 10 ekspertë të rehabilitimit, fizioterapistë dhe infermierë që ndihmojnë familjen e kampionit për ta shpejtuar rimëkëmbjen e tij", raporton "Bild". Në pesë vjetët e fundit zyra e vjetër e Schumit është shndërruar në një dhomë spitalore super të pajisur. "Asgjë nuk është lënë pa bërë për ta shpejtuar shërimin e Schumacherit", shkruan "Bild", që bën me dije, ndër të tjera, se atij i ofrohet për t'i dëgjuar zhurmat e makinës së tij të garave. Për pyetjen si është gjendja e Schumacherit, "Bild" përgjigjet: "Kampioni i Ferrarit nuk është më në rrezik për jetën!"

Rashfordi, objektiv i Barçës

Barcelona po synon transferimin e sulmuesit të Manchester Unitedit, Marcus Rashford. Lajmi është bërë me dije të enjten nga "Mundo Deportivo", kurse kampionët e Spanjës janë gati të ofrojnë 100 milionë për shërbimet e sulmuesit anglez. Nuk do të jetë lehtë realizimi i këtij transferimi për faktin se Rashford është një fans i Unitedit dhe nën drejtimin e Ole Gunnar Solskjaer është një nga lojtarët kryesor.

Guardiola: Ende nuk jemi gati ta fitojmë Ligën e Kampionëve

Manchester City e mposhti Schalke 04 me rezultat 2-3, por trajneri Pep Guardiola është shprehur se City ende nuk është i gatshëm për ta fituar Ligën e Kampionëve. "Tre gola dhe rezultati është i pabesueshëm, por ende nuk jemi gati të luftojmë për Ligën e Kampionëve. Jam më shumë se i kënaqur me rezultatin, por nuk është e mjaftueshme në këtë garë. Ne u dhuruam atyre dy gola dhe kartonin e kuq. Në fazat e fundit, nëse e bëjmë këtë, jemi jashtë garës. Ne jemi një ekip i mirë për t'u parë dhe shënojmë një sasi të jashtëzakonshme të golave. Personaliteti dhe mënyra se si luajmë është i mirë, por nuk mjafton. Ne u dhamë atyre mundësi. Ndoshta e kuptojmë rezultatin dhe mësojmë nga kjo, por çdo fazë është më e vështirë", ka thënë Guardiola.

Atletico dominon formacionin në Ligën e Kampionëve

Atletico Madridi e mposhti Juventusin (2-0) në ndeshjen e parë të 1/8 së finales në Ligën e Kampionëve. Skuadra spanjolle dominon në formacionin e javës me katër lojtarë, kurse nga dy lojtar i kanë Manchester City dhe Barcelona. Ndërsa nga një lojtar i kanë Bayern Munchen, Schalke 04 dhe Lyon. Formacioni: Lopez (Lyon), Semedo (Barcelona), Gimenez (Atletico), Godin (Atletico), Filipe Luis (Atletico), Martinez (Bayern), Bentaleb (Schalke), Sterling (City), Messi



Republika e Kosovës / Republika Kosovo / Republic Of Kosovo
Komuna e Rahovecit/ Opština Orahovac/Municipality of Rahovec



Njësia e Personelit / Jedinica za Personel / Personnel Unit

01Nr/Br.176
Me datë/Dana: 21.02.2019
Rahovec/Orahovac

Në bazë të nenit 66 pika 2 e Ligjit për Vetëqeverisjes Lokale Nr. 03/L-040, nenit 8 dhe 16 të Ligjit të Punës Nr. 03/L-212, Njësia e Personelit të komunës së Rahovecit shpall: Na osnovu člana 66. tačka 2. Zakona o Lokalnoj Samoupravi Br.03/L-040, člana 8 i 16. Zakona o radu Br. 03/L-212, Jedinica za Osoblje opštine Orahovac, objavljuje:

KONKURS

Titulli i vendit të punës:

Praktikantë për efikasitetin e energjisë (2 pozita).

Naziv radnog mesta:

Praktikant oblasti Stednje energije

Punëdhënësi: Asociacioni i Komunave të Kosovës-AKK.

Poslodavac: Asociacija Kosovskih Opština - AKO

Kualifikimet, aftësitë dhe përvoja e kërkuar

Potrebne kvalifikacije, sposobnosti i iskustva

Kualifikimet: Të ketë Diplomë pasuniversitare ose të paktën diplomë Bachelor e preferueshme është fusha e inzhinierisë teknike dhe shkencat kompjuterike

Kvalifikacije: Da ima univerzitetsku diplomu ili najamanje Bachelor, poželjno u oblast tehničke inženjerije i kompjuterske nauke.

Përvoja: Përvoja paraprake në projekte në fushën e efikasitetit të energjisë dhe ajo në mbledhjen dhe procesimin e të dhënave do të konsiderohet përparësi.

Iskustvo: Prethodno iskustvo u oblasti štednje energije i na prikupljanju i procesuiranju podataka će se smatrati prednost.

Njohuri /shkathhtësi/përgatitje tjera

- Njohuri të shkëlqyera në kompjuter, shkrim, komunikim dhe aftësi prezantimi;
- Të jetë i/e mirë organizuar;
- Të ketë aftësi humluese;
- Të ketë aftësi për të punuar në grup;
- Te jete i gatshëm të marrë përgjegjësi të tjera, gjithmonë në përputhje me kërkesat dhe kriteret e fushëveprimit;
- Te ketë njohuri të mira të gjuhës angleze dhe gjuhëve kombëtare.

Poznavanje/ sposobnosti/ ostale sposobnosti

- Odlično poznavanje rada na kopjuteru, pisanja, komunikacije i sposobnost prezentacije;
- Da je dobro organizovan/a;
- Da je sposoban/na da istraživa;
- Da je sposoban/na da radi u grupi
- Da je spreman/na da prihvati ostale dužnosti, uvek u skladu sa zahtevima i kriterijumima delokruga;
- Da poznaje dobro engleski jezik i nacionalne jezike.

Lokacioni: Zyrat e administratës komunale të Rahovecit.

Lokacija: Kancelarije opštinske uprave Orahovac.

Kohëzgjatja: Praktika do të zgjasë dy muaj. Praktika është me orar të plotë (8 orë në ditë, 40 orë në javë)

Rok: Praktika do të trajtojë dy muaj. Praktika je punog radnog vremena (8 sati dnevno, 40 sati nedeljno)

Pagesa: Pagesa për praktikantët do të jetë 200 euro bruto në muaj (përfshirë të gjitha taksat e aplikueshme në Kosovë)

Naplata: Naplata za praksu biće 200 evra bruto, mesečno (uključujući sve sprovodljive takse na Kosovu)

Detyrat dhe përgjegjësit:

- Futjen dhe procesimin e të dhënave në Sistemin e Menaxhimit të Energjisë;
- Mbështesë menaxherin komunal për energji në aktivitetet e ndërlydhura me procesimin e të dhënave për hartimin e Planit Komunal të Veprimit për Efikasitet të Energjisë;
- Bashkëpunimi me departamentet përgjegjëse në komuna për të siguruar informacionin e kërkuar në lidhje me konsumin e energjisë në ndërtesat publike dhe ndriçimit rrugor;
- Mbështesë menaxherin për energji në përmbushjen e detyrave të tyre lidhur me zhvillimin e mëtejshëm të sistemit të menaxhimit të energjisë;
- Detyrat tjera sipas kërkesës/vevojës së paraqitur;

Zadaci i odgovornosti:

- Ubacivanje i procesiranje podataka u Sistem Menadžiranja Energije;
- Da pruži podršku opštinskom menadžeru za energiju u aktivnostima nadovezanih sa procesiranjem podataka za izradu Opštinskog Plana Delovanja za Štednju Energiju;
- Saradnja sa odgovornim odeljenjima opština radi obezbeđivanja traženih informacija u vezi potrošnje energije u javnim objektima i ulične rasvete;
- Da pruži podršku menadžeru za energiju na ispunjavanje njihovih obaveza u vezi daljnje razvoja sistema menadžiranja energije;
- Ostali zadaci prema zahtevu/potrebi;

Kushtet e pjesëmarrjes në rekrutim:

Të drejtë konkurrimi në këtë pozitë kanë shtetasit e Republikës së Kosovës të moshës madhore, të cilët kanë zotësi të plotë për të vepruar, janë në posedim të të drejtave civile dhe politike, kanë përgatitjen e nevojshme arsimore dhe aftësinë profesionale për kryerjen e detyrave dhe të cilët kanë aftësi fizike, që kërkohen për pozitën përkatëse.

Uslovi učesća na konkurs:

Pravo konkurisanja na ovaj položaj imaju državljani Republike Kosova zrelog doba, koji imaju potpunu sposobnost za delovanje, poseduju građanska i politička prava, poseduju potrebnu školsku i stručnu spremu za izvršavanje zadatka i koji poseduju fizičku sposobnost koja se traži za dotični položaj.

Dokumentet:

Diploma
Certifikata që nuk është nën hetime
Certifikata e lindjes
Kopja e letërnjoftimit
CV-ja

Dokumenta:

Diploma
Uverenje da nije pod istragu
Izvod rođenja
Kopija lične karte
CV.

Data e mbylljes së konkursit: Konkursi është i hapur 5 ditë kalendrike nga dita e publikimit.

Datum zatvaranja konkursa: Konkurs je otvoren 5 dana od dana objavljivanja.

Paraqitja e kërkesave:

Aplikacionet merren dhe dorëzohen në Komunën e Rahovecit- Zyrën e pranimit në katin përdhës. Aplikacionit i bashkëngjiten kopjet e dokumentacionit të nevojshme, siç kërkohet te pjesa e konkursit - **dokumentet**.

Podnošenje zahteva:

Zahtevi (aplikacije) uzimaju se i predaju u Prijemnoj kancelariji Opštine Orahovac –prizemni sprat. Zahtevu – aplikaciji se prilaže potrebna dokumentacija, kako se traži kod dela konkursa - **dokumenta**. Kërkesat e dërguara pas datës së fundit nuk do të pranohen, kërkesat e pakompletuara do të refuzohen. Zahtevi podneti van roka neće se uzeti u obzir, a nekompletirani zahtevi će se odbiti.

Në rast të numrit të madh të kërkesave të pranuar, vetëm kandidatët e përzgjedhur në listën e ngushtë do të kontaktohen.

U slučaju većeg broja primljenih zahteva, samo odabrani kandidati u užoj listi će se kontaktirati.



Nr. ___

Prishtinë, më: 21.02.2019

Në bazë të nenit 30 të Ligjit për Odën Ekonomike të Kosovës nr. 2004/7, nenit 52 të Statutit të Odës Ekonomike të Kosovës dhe Projektit: **“Nxitja e Transformimit Digjital të Ndërmarrjeve të Vogla dhe të Mesme”** nr: 952/1 nga MIN, Sekretari i Përgjithshëm i OEK-ut shpall:

FTESË PUBLIKE PËR OFERTIMIN E PAISJEVE TË IT-së

Oda Ekonomike e Kosovës, shpall këtë ftesë publike për dërgimin e ofertave për paisje të IT-së sipas specifikacioneve të kërkuara si më poshtë.

Paisjet:

- Pozicioni 1: Laptop**
- Pozicioni 2: Tablet**
- Pozicioni 3: PC**
- Pozicioni 4: Printer**
- Pozicioni 5: Projektor**
- Pozicioni 6: White Board**
- Pozicioni 7: Pano**
- Pozicioni 8: Raft – Kabinet**
- Pozicioni 9: Pano për projektor**

Për specifikacionet teknike të detajuara i gjeni në webfaqen e OEK-ut

www.oek-kcc.org.

Kompania duhet të ketë eksperiencë në këtë fushë të punës dhe të jetë e aftë për të siguruar paisjet sipas kërkesave teknike.

Si kriter i përzgjedhur do të jetë çmimi më i ulët.

Afati i fundit për aplikim është më datë 04 Mars 2019. Publikimin mund ta gjeni në gazetën Koha Ditore, webfaqen dhe facebook-un e OEK-ut, www.oek-kcc.org.

Ofertuesi mund të dërgoj ofertën për të gjitha pozicionet apo ndaras për secilin pozicion në këtë email adresë: fatmire.shala@oek-kcc.org.

Me respekt,

Oda Ekonomike e Kosovës

Duke u bazuar në Ligjin Nr. 03/L-214 për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis, Neni 20, pika 2 dhe 4, Kompania "Swiss Wellness Park" Sh.p.k Babin Most, Obiliq, në bashkëpunim me Ministrin e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, organizojnë:

DEBAT PUBLIK

Për Raportin e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis për qendër rekreative dhe sportive në pishinë në Babin Most komuna e Obiliqit.

Njoftohet publiku i interesuar se më datën 18.03. 2019 në ora 11:00 në hapësirat e objektit të kompanisë "Swiss Wellness Park" në Babin Most komuna e Obiliqit do të organizohet debat publik nga kompania "Swiss Wellness Park" Sh.p.k Babin Most, Obiliq, në bashkëpunim me Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor.

Debati publik do të organizohet për Raportin e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis për qendër rekreative dhe sportive në pishinë në Babin Most komuna e Obiliqit.

Pjesëmarrja e juaj na ndihmon në implementimin e projektit.



Republika e Kosovës
Rpublika Kosova/ Republik of Kosovo
Komuna Dragash/ Opština Dragaš / Daragas Municipality

Në bazë të nenit 11 par.4 dhe nenit 12 par.1 pika 1.1 të ligjit nr.03/L-149 për Sherbimin Civil të Kosovës, neni 3 dhe 4 të Rregullores nr.02/2010 për procedurat e rekrutimit në Sherbimin Civil dhe në bazë të kërkesës së Udhëheqës të Zyres për Komunitete dhe Kthim K. Dragash me nr.02.111/01-3409 të drejtuar në zyrën e shërbimit të personelit KK Dragash për pranimin e një punëtori, zyra e Shërbimit të Personelit pranë KK Dragash publikon këtë;

KONKURS
për minoritete

Titulli i Punës: Zyrar për Koordinimin e Kthimit të Qëndrueshem
Njësia: Zyra për Komunitete dhe Kthim
Niveli i pages, Koeficienti: 7
Orari i punës: Me orar të plotë (40 orë në javë)
I raporton: Shefit të Zyres për Komunitete dhe Kthim
Qëllimi i vendit të punës: Krijimin e kushteve për kthim të qëndrueshëm, për ri integrim të refugjatëve, personave të zhvendosur si dhe personave të riatdhesuar
Detyrat dhe përgjegjësitë:

1. Harton dhe zhvillon planin e punës në pajtim me mbikëqyrësin për zbatimin e detyrave të përcaktuara në bazë të objektivave të njësisë dhe jep rekomandime lidhur me realizimin e këtyre objektivave;
2. Ofron shënime për hartimin e buxhetit vjetor të sektorit, me qëllim të implementimit të projekteve të planifikuara dhe aktiviteteve të sektorit;
3. Ndihmon dhe këshillon në zbatimin e strategjisë dhe programeve të miratuara për krijimin e kushteve për kthim të qëndrueshëm, për ri integrim të refugjatëve, personave të zhvendosur si dhe personave të riatdhesuar;
4. Siguron mbikëqyrjen e progresit të arritur në lëmin e kthimit dhe ri integrimin si dhe kontribuon në raportet e ZKKK-së, përfshirë raportin vjetor të Sektorit;
5. Koordinon dhe bashkëpunon me organizatat lokale dhe ndërkombëtare të angazhuara në procesin e kthimit dhe ri integrimin, sidomos në përgatitjen e buxhetit dhe zbatimin e strategjisë komunale për kthim;
